



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 204/13

Nr. i fq. / Bc. sh. -1-

Data / Datum 10.09.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **10.09.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Buxhetin për vitin 2014 dhe lista e projekteve prioritare, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Buxheti për vitin 2014 dhe lista e projekteve prioritare.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 11.09.2013 dhe zgjatë deri më 24.09.2013.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna dhe nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së më 26 Shtator 2013.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	203/13
Nr. i fq. / Br. sh	-1-
Data: / Datum	10.09.2013
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **10.09.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Strategjisë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2013-2018, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Strategjia për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2013-2018.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 11.09.2013 dhe zgjatë deri më 24.09.2013.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Koordinator i Grupit Punues që si hartues dhe propozues i Draft-strategjisë në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu Koordinator i Grupit Punues obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-strategjisë në fjalë në mbledhjen e KK-së më 26 Shtator 2013.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa

